

Korniza Vet-Vlerësuese e Kodit të Standardeve për OJF-ve në Shqipëri

**© 2021 by Partners Albania for Change and Development.
All rights reserved**

HYRJE

Korniza Vet-Vlerësuese e Kodit të Standardeve (KS) të OJF-ve në Shqipëri përbën dokumentin bazë, mbi të cilin do të bazohet vlerësimi i përbushjes së kriterëve të anëtarësimit në KS.

Korniza është e organizuar në tre kapituj. Kapitulli I, Parimet Udhëheqëse të Kodit të Standardeve, na prezanton me 4 parimet që udhëheqin anëtarët e KS përgjatë veprimtarisë së tyre, bashkë me një listë mekanizmash dhe praktika organizative në përbushje të parimeve. Praktikant e sugjeruara kanë si qëllim prezantimin e organizatës aplikuese me kërkesat bazë parimore në kuadër të anëtarësimit në KS, të zhvilluara më në detaje përgjatë pjesës së dytë të Kornizës.

Kapitulli II, Angazhimet, përbën thelbin e këtij vet-vlerësimi që organizata aplikuese do të duhet të plotësojë, për të vlerësuar nivelin e përbushjes së standardeve të KS. Ai paraqet një set treguesish të verifikueshëm, në përbushje të 7 angazhimeve të Kodit, si dhe një listë provash në dëshmi të përbushjes së treguesve. Treguesit dhe provat janë klasifikuar në të detyrueshëm dhe të preferueshëm. Treguesit e detyrueshëm përbëjnë minimumin bazë të kërkesave për anëtarësim në Kod, ndërkohë treguesit e preferueshëm i referohen përbushjes së standardeve të Kodit në një nivel më të lartë. Organizata aplikuese do të duhet të plotësojë jo më pak se 40% të treguesve të detyrueshëm për çdo angazhim që të mund të anëtarësohet në Kodin e Standardeve.

Kapitulli III, Marrja e reagimit (Feedback-ut) prezanton dhe trajton një praktikë të re në marrjen e feedback-ut për secilin nga angazhimet e ndërmarra në përbushje të standardeve të Kodit. Prezantimi i kësaj praktike organizative synon një vendimarrje gjithëpërfshirëse dhe përmirësimin e impaktit të veprimtarisë së organizatës në të ardhmen, bazuar në rekomandimet dhe sugjerimet e mbledhura. Marrja e Feedback-u edhe pse pjesë e Kornizës vet-vlerësuese, nuk është e përfshirë në përlogaritjen në përqindje të vlerësimit për anëtarësim në Kodin e Standardeve.

PARIMET UDHËHEQËSE TË KODIT TË STANDARDEVE

Parimi 1: OJF-të anëtare të KS, si vlerë kryesore kanë respektimin e të drejtave universale të njeriut dhe promovimin e barazisë gjinore.

“Ne tregojmë angazhim organizativ në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore gjatë veprimtarisë së organizatës dhe në procedurat tona të brendshme. Nëpërmjet nismave tona, ne kontribuojmë për krijimin e mundësive për të drejta të barabarta. “

Praktika organizative dhe mekanizma të sugjeruar:

- ✓ politika, manuale apo dokumenta të tjerë të brendshëm që dëshmojnë dhe i angazhojnë OJF-të anëtare të Kodit në respektimin e të drejtave të njeriut dhe promovimin e barazisë gjinore, e që theksojnë se këto të drejta i përkasin çdo njeriu pavarësisht racës, besimit, etnisë, aftësive, përkatësisë gjinore, orientimit seksual, statusit social-ekonomik, etj;
- ✓ angazhime të shprehura në statutin e organizatës, misionin, vizionin apo politika të brendshme për mbrojtjen e përfituesve dhe punonjësve nga diskriminimi;
- ✓ përfshirje dhe/ose anëtarësime në nisma që dëshmojnë promovimin në mënyrë aktive të të drejtave të njeriut nga anëtarët përgjatë tre viteve të fundit;
- ✓ projekte, evente, raporte etj. që dëshmojnë synime të drejtpërdrejta apo në mënyrë të tërthortë të respektimit të të drejtave të njeriut dhe promovimit të barazisë gjinore, si dhe një përqasje programatike të bazuar në të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore përgjatë tre viteve të fundit;
- ✓ punonjës ose strukturë e mundshme në organikën e organizatës, të angazhuar në zbatimin e parimit;
- ✓ angazhime të mundshme të organizatës në media për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e barazisë gjinore.

PARIMET UDHËHEQËSE TË KODIT TË STANDARDEVE

Parimi 2: OJF-të anëtare të KS do të promovojnë dhe advokojnë për drejtësi dhe barazi.

“Ne tregojmë angazhim organizativ për drejtësi dhe barazi në veprimtarinë tonë të brendëshme. Nëpërmjet nismave tona, ne kontribuojmë në promovimin dhe advokimin për drejtësi dhe barazi.”

Praktika organizative dhe mekanizma të sugjeruar:

- ✓ politika, udhëzues ose dokumenta të tjerë të brendshëm që i angazhojnë organizatat anëtare ndaj drejtësisë dhe barazisë;
- ✓ angazhime të shprehura në statutin, misionin, vizionin apo politika të brendshme të organizatës për mbrojtjen e grupeve të interesit¹ dhe punonjësve të saj nga diskriminimi, dhuna ose kërcënimi, etj. të rëndësishme në këtë kontekst;
- ✓ përfshirje ose/dhe anëtarësime në nisma përgjatë tre viteve të fundit, që dëshmojnë promovimin e tolerancës në mënyrë aktive;
- ✓ projekte, evente, raporte etj. përgjatë tre viteve të fundit që dëshmojnë mbi informacione të sakta ose fushata advokimi të mbështetura/ zbatuara nga organizata, të cilat promovojnë diversitetin, drejtësinë, tolerancën, barazinë, të drejtat e njeriut, etj.;
- ✓ ndërmarrja e nismave advokuese për drejtësi dhe barazi.

¹Në këtë dokument termi grupe interesi do të nënkuptojë përfituesit organizatave, mbështetësit, komunitetin e donatorëve, partnerë nga sektorë të tjerë dhe institucioneve publike

PARIMET UDHËHEQËSE TË KODIT TË STANDARDEVE

Parimi 3: OJF-të anëtare të KS do të nxisin, në të gjitha aspektet e punës së tyre, pjesëmarrjen aktive të qytetarëve të interesuar dhe komuniteteve vendore.

“Ne kemi mekanizma të miratuar dhe mjete efektive që grupet tona të interesit, të kontribuojnë me ide, të shprehin interesat, prioritetet dhe opinionet e tyre. Në nismat tona, grupet e interesit janë të përfshirë në mënyrë aktive në analizimin e situatës, planifikimin strategjik, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e fushave tona programatike.”

Praktika organizative dhe mekanizma të sugjeruar:

- ✓ politika, udhëzues ose dokumenta të tjerë mbi mënyrën e mbledhjes, analizimit dhe përdorimit të feedback-ut të marrë;
- ✓ mjete, mekanizma apo procedura që mundësojnë bërjen e ankesave dhe dhënien në mënyrë anonime të opinionëve, interesave, etj. nga grupet e interesit dhe më gjerë ndaj organizatës;
- ✓ punonjës i angazhuar në mbledhjen dhe kthim përgjigje ndaj feedback-ut të marrë;
- ✓ dokumentacion mbi takime periodike me palët e interesuara apo mbi vëzhgime/ anketime të kryera me grupet e interesit;
- ✓ grumbullimi dhe marrja e opinionit publik mbi veprimtarinë e organizatës dhe veprime të ndërmarra kundrejt rezultateve të opinionit të tyre;
- ✓ procedura të përcaktuara dhe monitoruara mbi përfshirjen në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e planeve strategjike të organizatës të grupeve të interesit;
- ✓ dokumentacion mbështetës prej grupeve të interesit dhe përfituesve për nisma të ndryshme;
- ✓ raporte vlerësimi që tregojnë përfshirjen e grupeve të interesit.

PARIMET UDHËHEQËSE TË KODIT TË STANDARDEVE

Parimi 4: OJF-të anëtare të KS do të tregojnë kujdes për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij

“Ne jemi të angazhuar si organizatë ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe nxitjes së zbatimit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor në veprimtarinë tonë të brendshme.”

Praktika organizative dhe mekanizma të sugjeruar:

- ✓ Politika, udhëzues ose dokumenta të tjerë të brendshme që e angazhojnë organizatën në manaxhim miqësor të mjedisit dhe burimeve, gjatë veprimtarisë së saj të brendshme dhe punës në komunitet;
- ✓ përfshirje dhe/ose anëtarësim në nisma që dëshmojnë angazhimin e organizatës ndaj kujdesit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

ANGAZHIMET E KODIT TË STANDARDEVE

Udhëzime për plotësimin e Kornizës

- ✓ Për çdo provë të disponuar, ju lutemi të plotësoni duke shënjuar kutinë përbri, në sesionin **“Dokumenta verifikues/ Prova”**, duke cilësuar në të njëjtën kohë dokumentin që dëshmon përmbushjen e treguesit (provën) si dhe nënçështjen/nenin specifik ku trajtohet përmbushja e treguesit (psh: Manuali i Politikave të Personelit, pika 2 “Mbrojtja e të Drejtave universale”);
- ✓ **Dokumentat dëshmuës** do të bashkëngjiten bashkë me Kornizën Vet-Vlerësuese të plotësuar, si pjesë e shprehjes së interesit për anëtarësim në Kodin e Standardeve;
- ✓ Seksioni **“Hapa të propozuara për përmirësim”**, do të plotësohet nga Komiteti i Kodit të Standardeve dhe do të dërgohet më pas organizatës;
- ✓ Seksioni **“Pyetje për marrjen e Feedbacku-ut”**, në rast se organizata zbaton praktika të tilla, duhet të plotësohet brenda kutizës së pyetjes ose në një dokument sqarues shtesë, që do të duhet t`i bashkëngjitet aplikimit.

ANGAZHIMI 1 : ORGANIZATA TË HAPURA DHE TRANSPARENTE

- A.** OJF-të anëtare të Kodit do të ndajnë dhe bëjnë publike informacione lidhur me misionin e tyre, veprimtarinë e organizatave, format dhe mënyrën e marrjes së vendimeve brenda organizatës, burimet si dhe ndikimin² e punës së tyre, qoftë ky negativ apo pozitiv, në kohë, në mënyrë të saktë, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme.
- B.** OJF-të anëtare të Kodit do të jenë të hapura ndaj kritikave rreth punës së tyre duke krijuar hapësira për dialog konstruktiv me palët që venë në dyshim veprimtarinë e tyre, me qëllim arritjen e një mirëkuptimi të përbashkët, kur ky është i mundur.
- C.** OJF-të anëtare të Kodit do të jenë të hapura dhe të përgjegjshme në veprimtarinë me institucionet publike, partnerët, donatorët dhe grupet e tjera të interesit.
- D.** Raportet përshkruese mbi aktivitetin vjetor dhe raportet financiare të OJF-ve anëtare të Kodit do të jenë publike dhe të disponueshme për publikun dhe të gjitha palët e interesuara.

STRUKTURA, PROCESHE DHE POLITIKA

TREGUESIT E PROGRESIT

1.1 Ne jemi një organizatë e hapur që ofron dhe siguron mënyra dhe forma për njerëzit/publikun që të përfshihen në një dialog konstruktiv mbi veprimtarinë tonë. Ne ndajmë të gjithë informacionin e rëndësishëm dhe raportet mbi aktivitetin dhe punën e organizatës, burimet e financimit dhe ndikimin e veprimtarisë tonë, në mënyrë të saktë, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme për të gjitha grupet e interesit.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- lista e mjeteve të përdorura për bërjen publike të misionit, vizionit, qëllimit dhe objektivave të organizatës, mënyrave të kontaktit dhe vendndodhjes së organizatës apo informacione të tjera mbi organizatën; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- lista e mjeteve të përdorura nga organizata për shpërndarjen e informacionit dhe publikimin e raporteve vjetore, për të gjithë grupet e interesit, shoqëruar me links përkatës në rast përdorimi të mjeteve online si faqe e internetit etj. si dhe me frekuencën e shpërndarjes së tyre; (e detyrueshme për t'u plotësuar)

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM*

Prova të plotësuar/
dokumenta mbështetës:

*për tu plotësuar nga Komiteti i Kodit të Standardeve

² Rezultate dhe efekte (pozitive dhe negative) të nismave, programeve apo aktiviteteve të organizatës.

TREGUESIT E PROGRESIT

1.1 Ne jemi një organizatë e hapur që ofron dhe siguron mënyra dhe forma për njerëzit/publikun që të përfshihen në një dialog konstruktiv mbi veprimtarinë tonë. Ne ndajmë të gjithë informacionin e rëndësishëm dhe raportet mbi aktivitetin dhe punën e organizatës, burimet e financimit dhe ndikimin e veprimtarisë tonë, në mënyrë të saktë, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme për të gjitha grupet e interesit.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- links të mjeteve online të publikimit të politikave dhe manualeve, raporteve të vlerësimit si dhe të dhëna të tjera statistikore të rëndësishme për veprimtarinë e organizatës; (e preferueshme për t'u plotësuar)
- dokumentimi i mënyrave/formave se si organizata i ka trajtuar problemet e hasuara apo/dhe pësime të mundshme dhe se si ka nxjerrë mësim prej tyre; (e preferueshme për t'u plotësuar)
- dokumentimi i feedback-ut të marrë dhe raportimit të përgjigjeve dhe/ose veprimeve të ndërmarra; përpjekje të tjera që dëshmojnë promovimin e transparencës dhe të mësuarit nga të tjerët; (e preferueshme për t'u plotësuar)
- publikimi i këtij vet-vlerësimi. (e preferueshme për t'u plotësuar)

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM

Prova të plotësuar/
dokumenta mbështetës:

-
-
-
-

TREGUESIT E PROGRESIT

1.2 Ne kemi përshkrime të qarta në politikat dhe/ose manualët tanë të brendshëm për transparencën ndaj përfituesve, mbështetësve dhe grupeve të tjera të interesit, të cilat vazhdimisht bëhen publike, ndahen dhe zbatohen.

(i preferueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- politika, procedura ose udhëzues që dëshmojnë angazhimin e organizatës ndaj të qenit e hapur dhe transparente;
- një tërësi veprimesh të dokumentuara në rast mosrespektimi/ papërputhshmërie me angazhimet e marra;
- përfshirja në nisma që promovojnë dhe nxisin transparencën e OJF-ve.

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM

Prova të plotësuar/
dokumenta mbështetës:

PYETJE MBI MARRJEN E FEEDBACK-UT ³

Si e kuptoni ju nëse grupet tuaja të interesit janë të kënaqur me aksesin dhe cilësinë e informacionit të ofruar rreth veprimtarisë së organizatës, burimeve të financimit dhe ndikimit të saj, si dhe aksesin që krijoni ndaj tyre për të diskutuar dhe ngritur çështje që ndikojnë në veprimtarinë e organizatës?

³ Një tërësi pyetjesh, sistemesh apo praktikash të formuara me qëllim marrjen e opinionit, qëndrimeve apo perceptimeve të grupeve të interesit për punën dhe ndikimin e OJF-ve. Këto informacione më tej përdoren për qëllime të ndryshme, duke përfshirë këtu ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese për përmirësimin e performancës. (ALNAP/ODI, Closing the Loop, 2014).

ANGAZHIMI 2 : ORGANIZATA TË ORIENTUARA DREJT PARTNERITETIT

- A.** OJF-të anëtare të KS do të identifikojnë organizata që punojnë drejt arritjes së qëllimeve të ngjashme dhe do të krijojnë partneritete dhe bashkëpunime, për të përmbushur në nivele të larta, qëllimet e përbashkëta dhe forcimin e mëtejshëm organizativ.
- B.** OJF-të anëtare të Kodit do të shkëmbejnë informacione, të dhëna, burime dhe njohuri. Vendimet e rëndësishme për sektorin jofitimprurës do të merren në mënyrë të organizuar dhe kur është e mundur në mënyrë kolektive.
- C.** OJF-të anëtare të Kodit do t'u vijnë në ndihmë OJF-ve të tjera, kur u kërkohet dhe kur e shohin të përshtatshme, në mënyrë që t'i fuqizojnë ato dhe të përmirësojnë performancën e tyre në të ardhmen.
- D.** OJF-të anëtare të Kodit nuk do të mohojnë punën e organizatave të tjera apo të paraqesin deklarata false ose të pasakta për organizatat e tjera. Anëtarët e KS do të njohin kontributin e OJF-ve të tjera dhe mbështetjen e dhënë në arritjet e sektorit.
- E.** OJF-të anëtare të KS do të respektojnë pavarësinë, misionin dhe veprimtarinë e organizatave të tjera, anëtare ose jo të KS të OJF-ve.

STRUKTURA, PROCES DHE POLITIKA

TREGUESIT E PROGRESIT

2.1 Partneritetet tona bazohen në frymën e bashkëpunimit, drejtësisë, mbështetjes së ndërsjellë dhe ndikimit të përbashkët.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- dokumente themelimi të rrjeteve apo koalicioneve, të zbatimit të nismave të përbashkëta, apo projekte të zbatuara në partneritet me organizata të tjera; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- shembuj të dokumentuar të ndarjes së burimeve/informacionit midis OJF-ve partnere; (e preferueshme për t'u plotësuar)
- pjesë të komunikimeve që paraqesin pozitivisht dhe promovojnë organizatat e tjera; (e preferueshme për t'u plotësuar)
- raporte vlerësimi të ndikimit të partneriteteve me organizata të tjera. (e preferueshme për t'u plotësuar)

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM*

Prova të plotësuar/
dokumenta mbështetës:

-
-
-
-

TREGUESIT E PROGRESIT

2.2 Ne kemi mekanizma dhe procese që sigurojnë një komunikim efektiv, shkëmbim informacioni, përvojash, e mësimi të ndërsjellë me organizata partnere dhe OJF të tjera.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

2.3 Ne kemi politika të qarta që na udhëheqin drejt arritjes së ndikimit maksimal të qëllimeve të përbashkëta.

(i preferueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- procesverbale, deklarata, minuta takimi, shënime, etj. të takimeve periodike/ ad hoc dhe proceseve vendimmarrëse për nisma të përbashkëta. (e detyrueshme për t'u plotësuar)

- mjete dhe mekanizma që mundësojnë informim, komunikim, shkëmbim informacioni, etj. (e preferueshme për t'u plotësuar)

-dokumentimi i konferencave dhe eventeve shkëmbyese dhe aktiviteteve të tjera. (e preferueshme për t'u plotësuar)

- politika, udhëzues apo dokumenta të tjerë të brendshëm mbi parimet dhe mekanizmat e partneritetit;

- marrëveshje partneriteti/ anëtarësie;

- politika për menaxhimin e konflikteve gjatë partneritetit.

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM

Prova të plotësuara/
dokumenta mbështetës:

PYETJE MBI MARRJEN E FEEDBACK-UT

Si e kuptoni ju që partnerët tuaj janë të kënaqur me parimet, vlerat dhe qasjet tuaja ndaj partneritetit dhe se ky partneritet është i drejtë dhe efektiv? Si e kuptoni ju që të gjitha organizatat partnere ndjejnë se bashkëpunimi forcon përpjekjet dhe ndikimin e tyre?

ANGAZHIMI 3 : QEVERISJE E MIRË

- A. OJF-të anëtare të Kodit do të qeverisen me drejtësi dhe përgjegjësi nga një organ qeverisës i pavarur, aktiv dhe i informuar.
- B. OJF-të anëtare të KS do të kenë zhvilluar dokumenta që përcaktojnë qartë misionin, vizionin, vlerat e organizatës, qëllimet e përgjithshme, fushat programatike dhe strukturën qeverisëse dhe vendimmarrëse.
- C. OJF-të anëtare të KS, kur e shohin të nevojshme, do të rishikojnë në mënyrë periodike dokumentet bazë të ngritjes dhe funksionimit të strukturave qeverisëse në përshtatje dhe përmbushje të misionit të tyre. Dokumentat bazë do të përfshijnë strukturat dhe procedurat qeverisëse, marrëdhëniet midis punonjësve dhe organeve qeverisëse si dhe proceset e vendimmarrjes.
- D. Organi i pavarur qeverisës i secilës organizatë anëtare të KS do të rishikojë dhe aprovojë buxhetin vjetor të organizatës, politikat e rëndësishme, vendimet kryesore financiare, planet dhe programet e organizatës.
- E. OJF-të anëtare të KS do të miratojnë politika që parandalojnë dhe administrojnë në mënyrë efektive situatat e konfliktit të interesit.
- F. Anëtarët e KS do të kenë zhvilluar dhe zbatojnë politika që ndalojnë diskriminimin dhe promovojnë barazinë gjinore si dhe pjesëmarrjen e grupeve të marginalizuara në të gjitha nivelet e organizatës.
- G. Anëtarët e KS do të kenë zhvilluar dhe zbatojnë politika që parandalojnë dhe administrojnë në mënyrë efektive ngacmimin seksual, bullizmin si dhe sinjalizimin në rast korrupsioni.

TREGUESIT E PROGRESIT

3.1 Ne kemi një strukturë efektive të qeverisjes që siguron udhëheqje të pavarur dhe të përgjegjshme të organizatës sonë, e cila i përgjigjet qartë misionit dhe vizionit të organizatës.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

STRUKTURA, PROCESHE DHE POLITIKA

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- dokumentimi i misionit të organizatës, vizionit, qëllimeve të përgjithshme, fushave programatike dhe strukturës qeverisëse (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- termat e referencës të Bordit Drejtues/ Asamblesë së organizatës, përcaktimi i përgjegjësive të Bordit/ Asamblesë sipas ligjit dhe më tej; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- shembuj të minutave të takimeve, komunikimit etj. që dokumentojnë vendimmarrjen strategjike dhe operacionale të organizatës nga Bordi/ Asambleja dhe përgjigjet/ndërhyrjet se si organizata ka vepruar në përgjigje të tyre; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- dokumenta që provojnë përfshirjen dhe/ose mbështetjen e anëtarëve të Bordit/Asamblesë në nisma advokimi apo aktivitete të organizatës. e preferueshme për t'u plotësuar

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM

Prova të plotësuar/ dokumenta mbështetës:

-
-
-
-

TREGUESIT E PROGRESIT

3.2 Ne kemi procese të qarta që mundësojnë punën aktive të organit qeverisës, zgjedhjen e tij dhe rishikimin e kornizës së qeverisjes.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

3.3 Ne kemi udhëzues dhe politika të qarta që ndalojnë diskriminimin, ngacmimin seksual, bullizmin, promovojnë diversitetin dhe rregullojnë sinjalizimin në rast korrupsioni dhe mënyrën se si ne sillemi në rast konflikti interesi.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

3.4 Ne tregojmë angazhim organizativ ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe nxitjes së zbatimit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor në veprimtarinë tonë të brendshme.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

PYETJE MBI MARRJEN E FEEDBACK-UT

Si e kuptoni ju, nëse punonjësit dhe përfituesit tuaj kanë besim në strukturën qeverisëse të organizatës dhe e shohin atë si një strukturë të përgjegjshme ndaj veprimtarisë dhe performancës së saj? Si e kuptoni ju nëse punonjësit dhe Bordi/Asambleja janë të kënaqur me masat që organizata ka marrë për të ndaluar diskriminimin, promovuar barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e grupeve të disavantazuar brenda organizatës?

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- dokumentim i procedurave të mirëqeverisjes së brendshme, rregullore ose përcaktime që udhëheqin zëvendësimin dhe përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të Bordit/ Asamblesë; (e detyrueshme për t'u plotësuar)

- dokumentim i mekanizmave bashkëpunues midis drejtuesit të organizatës dhe Bordit/ Asamblesë; (e detyrueshme për t'u plotësuar)

- parashikim i afateve mbi procesin e rishikimit të kornizës qeverisëse. (e preferueshme për tu plotësuar)

- politika, deklarata apo udhëzues respektivë për secilën nga çështjet; (e detyrueshme për t'u plotësuar)

- dokumentim i mundshëm i rasteve ku organizata ka promovuar me sukses diversitetin/ trajtimin e konfliktit të interesave në lidhje me marrëdhëniet politike, ekonomike dhe personale të Bordit/ Asamblesë dhe punonjësve. (e preferueshme për t'u plotësuar)

- politika, deklarata, udhëzues ose dokumenta të tjerë që e angazhojnë organizatën në menaxhim miqësor të mjedisit dhe burimeve, gjatë veprimtarisë së saj të brendshme dhe punës në komunitet; (e detyrueshme për t'u plotësuar)

- përfshirje dhe/ose anëtarësim në nisma që dëshmojnë angazhimin tuaj ndaj kujdesit dhe qëndrueshmërisë së mjedisit. (e preferueshme për t'u plotësuar)

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM

Prova të plotësuar/ dokumenta mbështetës:

ANGAZHIMI 4 : INTEGRITET ORGANIZATIV

- A.** Veprimtaria e OJF-ve anëtare të KS do të zhvillohet me integritet dhe transparencë. Organizatat do të publikojnë dhe shpërndajnë në mënyrë të plotë, të hapur dhe të saktë, informacione të rëndësishme në lidhje me qëllimet, programet, financat, aktivitetet, rezultatet, efektivitetin dhe qeverisjen e tyre.
- B.** OJF-të anëtare të KS do të veprojnë sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- C.** Anëtarët e KS, nuk do të lejojnë asnjë reklamim apo ndikim të partive ose grupeve politike dhe as nuk do të ndikojnë në qëndrimet politike ndaj të tjerëve. Bindjet politike nuk duhet të ndërhyjnë në punën e anëtarëve të KS.
- D.** OJF-të anëtare të KS do të jenë të pavarur në punën e tyre dhe do të bashkëpunojnë me institucionet shtetërore, donatorët dhe entitetet e tjera bazuar në parimin e barazisë, në përputhje me qëllimet e tyre statutores.

STRUKTURA, PROCESHE DHE POLITIKA

TREGUESIT E PROGRESIT

4.1 Ne kemi një sistem menaxhimi që plotëson kërkesat ligjore, strukturore dhe operacionale që siguron veprimtari transparente dhe të përgjegjshme.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- dokumentacion që vërteton se kërkesat ligjore dhe rregullatore për veprimtarinë e organizatës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi janë përmbushur (përfshi këtu pasjen e licensës për organizata që ofrojnë shërbime të licensuara); (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- organograma e organizatës; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- dokumenta të strukturës së organeve qeverisëse dhe mënyrës së marrjes së vendimeve; (e detyrueshme për t'u plotësuar)

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM*

Prova të plotësuar/
dokumenta mbështetës:

-
-
-

*për tu plotësuar nga Komiteti i Kodit të Standardeve

TREGUESIT E PROGRESIT

4.1 Ne kemi një sistem menaxhimi që plotëson kërkesat ligjore, strukturore dhe operacionale që siguron veprimtari transparente dhe të përgjegjshme.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

4.2 Ne kemi udhëzime dhe politika të qarta që shprehin paanshmërinë politike dhe pavarësinë e punës së organizatës.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- CV dhe dëshmi profesionale të kualifikimeve të punonjësve për pozicionin e punës (për profesionet të cilat kërkohet) / dëshmi profesionale për profesionet e rregulluara; (e preferueshme për t'u plotësuar)

- dëshmi profesionale dhe të tjera mbi kualifikimin dhe përvojën e punonjësve; (e preferueshme për t'u plotësuar)

- links/ mjete/ prova të ndarjes apo bërjes publike të dokumentave të mësipërm. (e preferueshme për t'u plotësuar)

- angazhime të shprehura në statut, apo dokumenta të tjerë të brendshëm ose publikë që konfirmojnë që organizata është politikisht e paanshme; (e detyrueshme për t'u plotësuar)

- politika të parandalimit dhe trajtimit të konflikteve të interesit; (e detyrueshme për t'u plotësuar)

- ndërmarrja/ përfshirja në nisma që promovojnë dhe dëshmojnë paanshmërinë politike të organizatës dhe pavarësinë e punës së saj. (e preferueshme për t'u plotësuar)

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM*

Prova të plotësuara/
dokumenta mbështetës:

PYETJE MBI MARRJEN E FEEDBACK-UT

Si e kuptoni ju që grupet tuaj të interesit kanë besim në integritetin e organizatës dhe përkushtimin ndaj paanshmërisë politike? Si e kuptoni ju që grupet tuaja të interesit kanë besim në aftësinë e organizatës për t'u përballur me rastet e konflikteve të brendshme të interesit?

*për tu plotësuar nga Komiteti i Kodit të Standardeve

ANGAZHIMI 5 : FINANCA, NGRITJA E FONDEVE DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NË MËNYRË ETIKE

- A.** OJF-të anëtare të KS do t`i sigurojnë burimet e tyre në përputhje me parimet e këtij kodi, vlerat dhe misionin e tyre, në mënyrë të pavarura dhe në përmbushje të qëllimeve të organizatës.
- B.** OJF-të anëtare të KS do t`i përdorin fondet dhe burimet e tyre financiare në mënyrë të përshtatshme dhe të përgjegjshme ndaj donatorëve. OJF-të do të operojnë sipas një buxheti të aprovuar nga organi qeverisës dhe do të kenë politika dhe procedura të miratuara të kontrollit të brendshëm financiar.
- C.** OJF-të anëtare të Kodit do të operojnë në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit dhe do të sigurojnë kontroll të rreptë financiar, për të zvogëluar rrezikun e korrupsionit, ryshfetit, keqpërdorimit të fondeve dhe konfliktit të interesit.
- D.** OJF-të anëtare të KS do të publikojnë raporte vjetore financiare lehtësisht të lexueshme dhe të aksesueshme për të gjithë palët e interesuara.
- E.** OJF-të anëtare të Kodit do t`i përdorin fondet sipas qëllimeve për të cilat janë zotuar në kërkesën për grant dhe sipas parashtrimeve kontraktuale me donatorin. Kur fondet mblidhen me kontributin e publikut ose kontribuesve të tjerë për një qëllim specifik, organizatat duhet të shprehin qartësisht, qëllimet e përdorimit të tyre në rast mbetje nga fondet e mbledhura.
- F.** OJF-të anëtare të KS do t`i administrojnë dhe përdorin burimet financiare sipas qëllimit për të cilin janë siguruar, në mënyrë që të maksimizojnë ndikimin drejt ndryshimeve pozitive afatgjatë. Donatorët do të kenë akses në informacione mbi fondet e dhëna prej tyre.

STRUKTURA, PROCESA DHE POLITIKA

TREGUESIT E PROGRESIT

5.1 Ne kemi një sistem menaxhimi dhe kontabiliteti që është i përshtatshëm me shkallën e kërkesës dhe riskut të organizatës sonë, duke siguruar që burimet tona janë përfituar dhe menaxhuar në mënyrë të përgjegjshme.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- dokumentim i objektivave dhe strategjive të funksionimit financiar të organizatës; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- organograma e organizatës, përshkrimi i punës dhe linjave të raportimit; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- dokumenta që përshkruajnë mekanizmat e menaxhimit të riskut, mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- listë të kualifikimeve dhe përvojave të punonjësve përgjegjës për financën. (e preferueshme për t'u plotësuar)

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM*

Prova të plotësuar/
dokumenta mbështetës:

TREGUESIT E PROGRESIT

5.2 Ne monitorojmë rregullisht shpenzimet tona dhe kur është e mundur, i certifikojmë ato përmes auditime vjetore të pavarura financiare, duke përdorur standardet kombëtare të kontabilitetit. Rezultati i auditimit publikohet dhe rekomandimet e dhëna zbatohen.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

5.3 Ne kemi udhëzues dhe procedura efektive për ngritjen etike të fondeve, prokurimin, përdorimin dhe administrimin e burimeve, me dispozita mbi: sigurimin dhe shpërndarjen e fondeve dhe dhurimeve në natyrë, parandalimin e mashtrimit dhe trajtimin e korrupsionit të dyshuar dhe të provuar dhe keqpërdorimit të burimeve.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- përshkrim dhe raportim i proceseve të monitorimit të brendshëm financiar; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- links të publikimit të raportit vjetor dhe financiar në faqen e internetit të organizatës; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- raport auditimi, nëse ka një të tillë; (e preferueshme për t'u plotësuar)
- dokumentacion mbi menaxhimin dhe ndryshimet e bëra në përgjigje të rekomandimeve; (e preferueshme për t'u plotësuar)

- politika, deklarata, dokumente udhëzuese ose vendime të organit drejtues që përshkruajnë kushtet që duhet të plotësohen për sigurimin dhe menaxhimin e burimeve në përputhje me vlerat e organizatës dhe standardin organizativ; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- udhëzime dhe politika mbi parimet e partneritetit, vlerat dhe përqsjet. (e preferueshme për t'u plotësuar)

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM

Prova të plotësuar/
dokumenta mbështetës:

PYETJE MBI MARRJEN E FEEDBACK-UT

Si e kuptoni ju nëse grupet tuaja të interesit mendojnë se organizata i përdor burimet e saj në mënyrën më të mirë të mundshme në përmbushje të misionit të saj dhe për një ndikimin sa më të lartë? Si e kuptoni ju nëse grupet tuaja të interesit janë të kënaqur me aksesin që ata kanë në informacionin mbi burimet dhe shpërndarjen e burimeve të organizatës?

ANGAZHIMI 6 : BURIME NJERËZORE TË MIRËMANAXHUARA

- A.** Të gjitha OJF-të anëtare të Kodit do të kenë politika dhe procedura të sigurta të rekrutimit të punonjësve, ekspertëve dhe vullnetarëve, të shkruara qartë dhe të mirëpërcaktuara, që mbrojnë dhe sigurojnë diversitetin dhe të drejtën e secilit individ.
- B.** OJF-të anëtare të Kodit do t'u sigurojnë punonjësve, ekspertëve dhe vullnetarëve përshkrime të qarta të detyrave dhe përgjegjësi të tyre si dhe pritshmëritë e organizatës ndaj tyre. Politikat e kompensimit dhe përfitimeve do të përshkruhen qartësisht dhe komunikohen periodikisht sipas ndryshimeve të mundshme.
- C.** OJF-të anëtare të KS do të investojnë në zhvillimin e potencialit të plotë të punonjësve dhe vullnetarëve të tyre, për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.
- D.** OJF-të anëtare të KS do të sigurojnë dhe nxisin përfshirjen e çdo niveli punonjësish në planifikime organizative dhe vendimmarrje, sipas niveleve dhe përgjegjësi të tyre në përputhje me politikat vendimmarrëse.

STRUKTURA, PROCESHE DHE POLITIKA

TREGUESIT E PROGRESIT

6.1 Ne mbështesim të drejtat themelore dhe ligjore të punës dhe sigurojmë një mjedis pune të drejtë dhe mbështetës për të gjithë punonjësit dhe vullnetarët.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- shembuj të kontratave dhe përshkrimeve të punës të punonjësve, ekspertëve dhe vullnetarëve; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- politika organizative ose deklarata që premtojnë diversitetin dhe mosdiskriminimin e punonjësve; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- politika të brendshme të miratuara që përshkruajnë fleksibilitetin e punëdhënësit ndaj punëmarrësit kundrejt nevojave dhe rasteve specifike lidhur me mirëritjen e fëmijëve, perkujdesjen ndaj familjarëve të tjerë, mundësisë së të punuarit me orar të kufizuar apo në distancë etj. (e preferueshme për t'u plotësuar)

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM*

Prova të plotësuar/
dokumenta mbështetës:



TREGUESIT E PROGRESIT

6.2 Ne vlerësojmë rregullisht performancën e punonjësve, nevojat e burimeve njerëzore si dhe përditësojmë përshkrimet e punës, përgjegjësitë dhe objektivat e punonjësve tanë.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

6.3 Ne kemi udhëzime dhe politika të qarta, që sigurojnë një mjedis pune të drejtë dhe mbështetës, në të cilin punonjësit dhe vullnetarët mund të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë profesional.

(i preferueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- politika personeli/ rekrutimi dhe manaxhimi të burimeve njerëzore; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- shembuj të formatit të vlerësimit të punonjësve; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- përmbledhje e zhvillimit / trajnimit të burimeve njerëzore ndër vite; (e preferueshme për t'u plotësuar)

- politika personeli/ manaxhimi të burimeve njerëzore;
- udhëzues për zhvillimin e burimeve njerëzore;
- politika dhe procedura që përcaktojnë proceset e vendimmarrjes në nivele të ndryshme brenda organizatës, sipas niveleve dhe përgjegjësive të punonjësve.

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM

Prova të plotësuara/
dokumenta mbështetës:

PYETJE MBI MARRJEN E FEEDBACK-UT

Si e kuptoni ju, nëse punonjësit, ekspertët dhe vullnetarët tuaj mendojnë që trajtohen në mënyrë të drejtë dhe se organizata respekton të drejtat e tyre të punës? Si e kuptoni ju nëse punonjësit dhe vullnetarët tuaj mendojnë se janë të përfshirë në mënyrë të përshtatshme në proceset vendimmarrëse?

ANGAZHIMI 7 : ADVOKIM I PËRGJEGJSHËM

- A.** Organizatat anëtare të Kodit do të sigurohen që advokimi i tyre të bazohet në parime dhe prova konkrete si dhe të pasqyrojë zërat lokalë të grupeve/ komuniteteve të përfshira në nismën e advokimit.
- B.** Kur është e mundur dhe e përshtatshme, OJF-të anëtare të Kodit do të ndërmarrin nisma advokimi në frymën e partneritetit dhe përgjegjësisë së përbashkët.
- C.** Deklaratat e përbashkëta dhe fushatat e advokimit do të konsultohen dhe zbatohen në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e interesuar të Kodit.

STRUKTURA, PROCES DHE POLITIKA

TREGUESIT E PROGRESIT

7.1 Fushatat tona advokuese janë gjithëpërfshirëse ku shqetësimet dhe problematikat e të gjithë grupeve të interesit dhe anëtarëve të komunitetit dëgjohen.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- raporte të nismave të mëparshme advokuese të lehtësuara apo koordinuara nga organizata; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- dëshmi të takimeve të rregullta për të diskutuar shqetësimet lokale dhe për të zhvilluar strategji të përbashkëta; (e detyrueshme për t'u plotësuar)
- procedura që rregullojnë mënyrën e komunikimit, në organizatë dhe jashtë saj si dhe angazhimin gjatë fushatave të advokasisë. (e preferueshme për t'u plotësuar)

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM*

Prova të plotësuara/
dokumenta mbështetës:

-
-
-

*për tu plotësuar nga Komiteti i Kodit të Standardeve

TREGUESIT E PROGRESIT

7.2 Nismat tona advokuese mbështeten në gjetje dhe prova hulumtuese si dhe pasqyrojnë perspektivën e përfituesve kryesorë.

(i detyrueshëm për t'u plotësuar)

7.3 Ne kemi politika dhe udhëzues të qartë se si i zhvillojmë nismat tona advokuese brenda organizatës.

(i preferueshëm për t'u plotësuar)

DOKUMENTA VERIFIKUES/ PROVA

Prova të mundshme janë:

- gjetje dhe rezultate të studimeve, anketime dhe hulumtime mbi tema dhe rrethana specifike që lidhen me fushatën advokuese;

(e detyrueshme për t'u plotësuar)

- deklarata që pasqyrojnë se avdokimi është i bazuar në prova, pasqyron perspektivën e popullatës së prekur dhe parandalon rritjen e nivelit të riskut për grupet e interesit më të ekspozuara; (e detyrueshme për t'u plotësuar)

- angazhime të mundshme të organizatës në media për rritjen e vizibilitetit të fushatave/ nismave advokuese.

(e preferueshme për t'u plotësuar)

- dokumentim i procedurave dhe kërkesave për një veprim të përbashkët brenda organizatës;

- dokumentim i përfshirjes dhe/ ose aprovimit të Bordit/ Asamblesë.

HAPA TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIM

Prova të plotësuar/ dokumenta mbështetës:



PYETJE MBI MARRJEN E FEEDBACK-UT

Si siguroheni ju që grupet tuaja të interesit i mbështesin nismat tuaja për advokim dhe i vlerësojnë ndryshimet e arritura nga ky advokim? Si e kuptoni ju nëse grupet tuaja të interesit janë të kënaqur me rezultatet e advokimit të organizatës dhe përfshirjen e tyre në të gjitha etapat e procesit?

PARIMET E MARRJES SË FEEDBACK-UT

HYRJE

Ky seksion prezanton një praktikë të re në veprimtarinë e OJF-ve sikurse është marrja e feedback-ut nga grupet e interesit mbi aspekte të veprimtarisë së organizatave të trajtuara në angazhimet e Kodit të Standardeve.

Prezantimi i kësaj praktike organizative synon përfshirjen e këtij procesi në praktikat organizative të OJF-ve me qëllim përmirësimin e impaktit të veprimtarisë së organizatave në të ardhmen, bazuar në rekomandimet dhe sugjerimet e mbledhura dhe një vendimmarrje sa më gjithëpërfshirëse.

Modeli i Marrjes së Feedback-u edhe pse pjesë e Kornizës vet-vlerësuese, nuk është i përfshirë në përlllogaritjen në përqindje të vlerësimit për anëtarësim në Kodin e Standardeve.

VENDIMMARRJE GJITHËPËRFSHIRËSE ME GRUPET TONA TË INTERESIT

PROCESI I MARRJES SË FEEDBACK-UT

KULTURA DHE PRAKTIKA TË MARRJES SË FEEDBACK-UT

ETAPAT E PROCESIT TË MARRJES SË FEEDBACK-UT

TREGUESI

PRAKTIKA TË ZHVILLUARA/ZBATUARA

Praktika të mundshme janë:

Hartimi	Ne kemi artikuluar qartë qëllimet e procesit të feedback-ut dhe kemi siguruar që ato të jenë në përputhje me misionin e organizatës, kapacitetin dhe teorinë e ndryshimit/ përmirësimit.	- Një plan i qartë se si organizata dëshiron të zhvillojë një proces feedback-u, me qëllime dhe procedura të qarta.
Mbledhja	Ne kemi mekanizma dhe procese që të gjithë të mund të komentojnë dhe të ngrenë pyetje në lidhje me informacionin që ndajmë, si dhe mekanizma e procese që mundësojnë konsultimin aktiv me grupet tona të interesit dhe marrjen e drejtpërdrejtë të feedback-ut prej tyre mbi punën tonë.	- mjete për grupet e interesit për të dhënë feedback si forma dhe numra kontakti në çdo raport të publikuar, prezantim publik i raporteve etj.;; - mekanizma ankimes; - raporte mbi dokumentimin/ ruajtjen e feedback-ut dhe ankesave; - dokumentim i vëzhgimeve dhe rezultateve të tyre; - gjetjet kerkimore; -dokumentimi i konferencave, seminareve apo grupeve të punës tematike që lejojnë pjesëmarrje dhe feedback.
Analizimi	Ne vlerësojmë reagimet/feedbacku-n që marrim, i adresojmë në kohë dhe mënyrë të saktë, sigurohemi që të kuptojmë përmes analizës dhe të identifikojmë fushat e përmirësimit.	- raporte agreguese mbi feedback-un e marrë; - politika të qarta mbi trajtimin e feedback-ut të kërkuar apo atij të shprehur lirshëm; - dokumentimi i intervistave shtesë për hulumtimin në thellësi të përgjigjeve të marra; - plan veprimi në përgjigje të feedbackut të marrë;
Dialogimi	Ne ndajmë analizat/ raportet tona me grupet e interesit dhe i hartojmë planet tona të veprimit së bashku me ta.	- minuta takimi, dokumentimi i bisedave të hapura mbi mënyra të përmirësimit të proceseve vendimmarrëse.
Rishikimi	Ne zbatojmë projekte, nisma dhe ofrojmë zgjidhjet që kemi zhvilluar në bashkëpunim me grupet tona të interesit.	- veprime të regjistruara/ruajtura/dokumentuara ndaj feedback-ut të marrë dhe verifikuar.

Rruga e Elbasanit, PARK GATE,
10th Floor, Ap. 71/73, 1010
Tirana, Albania

Telefon: 00355 4 2254 881

Email: info@resourcecentre.al